

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-001-15

Prishtinë, 4 maj 2016

Në çështjen juridike të:

B. S.

Pala ankuese/Paraqitësi i kërkesës

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetari i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Beshir Islami, gjyqtarë, duke vendosur për ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) Nr. KPCC/D/R/237/2014 (lënda e regjistruar me numër KPA50325) të datës 30 Prill 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 4 maj 2015, bie këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e B. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/237/2014, të datës 30 Prill 2014 për sa i përket lëndës KPA50325.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/237/2014, i datës 30 Prill 2014, për sa i përket lëndës KPA50325.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 07 Nëntor 2007, B. S. (në tekstin e mëtejme “Paraqitësi i kërkesës”) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar vërtetimin e të drejtës pronësore të babait të tij dhe ri-posedimin e shtëpisë me oborr e cila gjendet në vendin e quajtur Bolnica, rruga Kninska, ngastra kadastrale 4406/4 Zona Kadastrale Prishtinë me sipërfaqe prej 3 ari e 34 metra katrorë.
2. Në kërkesën e përmendur ai kishte kërkuar edhe 83 metra katrorë tokë ndërtimore që evidentohet në ngastrën kadastrale 4406/5 të cilën pretendonte se e ka fituar me ndarje të tokës shoqërore dhe me vendimin e autoriteteve dhe se kjo pjesë i ngjitej pronës në ngastrën 4406/04.
3. Për shkak të lehtësimit të përpunimit të kërkesave, Sekretariati Ekzekutiv i Agjencisë e kishte mbajtur kërkesën ekzistuese KPA50325 për ngastrën 4406/4 dhe kishte ndarë në Kërkesë të veçantë dhe regjistruar me numrin KPA91584 e cila lidhet me pronën në ngastrën 4406/5 (shihë shkresën e Agjencisë mbi ndarjen e parcelave të mdatës 05 tetor 2010).
4. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka dorëzuar këto dokumente:
 - Përshkrimin e Fletës Poseduese nr. 4212 nga Zyra Kadastrale ne Komunen e Prishtinës që dëshmon se parcela 4406/4 është e evidentuar në emër të bartësit të së drejtës pronësore, babait të paraqitësit të kërkesës D. S.;
 - Përshkrimin e Fletës Poseduese nr.10316 nga Zyra Kadastrale ne Komunën e Prishtinës që dëshmon se parcela 4406/5 me sipërfaqe prej 83 metra katrorë është e evidentuar si pronë shoqërore shfrytëzues Qendra Klinike Spitalore e Prishtinës.
 - Kopje plani për parcelën 4406/4 i datës 29.05.1975

- Aktvendim mbi përcaktimin e tatimit në pronë nr.436-1/19574 për vitin 1997 lëshuar nga Administrata për te ardhurat publike;
 - Aktvendim mbi dhënien në shfrytëzim të tokës shoqërore te evidentuat në prcelën 4406/05 në sipërfaqe prej 83 metra katrorë Nr.07-360—420-96-03 datë 24.07.1996
 - Shkrese me numër 07-172/88-02 i datës 25 Korrik 1988 me të cilën Keshilli Ekzekutiv obligohej që të stehonte një familje për të liruar pronën që duhej lënë në shfrytezim paraqitesit të kerkeses.
 - Leje ndërtimi me nr. 05-3242 pa date;
 - Vendim i Këshillit Popullor të Komunës së Prishtinës datë 20 Shtator 1961 Nr. 04-11192;
 - Certifikatë e vdekjes së bartësit të së drejtës pronësore D.S. e datës 30.05.2001
 - Letërnjoftim i paraqitësit të kërkesës lëshuar nga autoritetet e Serbisë me 31.08.2001
5. Më 29 01.2008 dhe 12 01.2011, AKP-ja ka vizituar pronën dhe ka vënë shenjën me të cilën njoftoheshin të interesuarit se prona ishte objekt i një kërkesë. Me 14 Janar 2011 është konstatuar se notifikimi është bërë korrekt. Prona është gjetur e okupuar nga N. S. i cili nuk ka pretenduar ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën përveç deklarimit se është në negociata me paraqitësin e kërkesës për arritjen e marrëveshjes për blerjen e pronës. Banuesi aktual ka refuzuar të nënshkruaje njoftimin për pjesëmarrje në procedurë.
 6. Në Raportin e konsoliduar të verifikimit të datës 2 Shkurt 2011, AKP-ja ka konstatuar se verifikimi për ngastrën 4406/04 është pozitiv dhe se mbi bazën e certifikatës së pronësis ngastra nr 4406/4 evidentohet në emër të babait të paraqitësit të kërkesës kurse ngastra 4406/5 është pronë shoqërore e Qendrës Klinike Spitalore të Prishtinës
 7. Sekretariati ekzekutiv i ka kërkuar paraqitësit të kërkesës dokumentin e blerjes së parcelës 4406/5 nga autoritetet por i njëjti nuk i ka sjelle.
 8. Në shkresat e lëndës është gjetur se pala ankuese kishte paraqitur kërkesë pranë Drejtoratit për Cështje pronësore dhe banesore për pronën e njëjtë dhe se drejtorati e kishte referuar kërkesën në Komisionin e Kërkesave pronësore dhe Banesore dhe se i njëjti e kishte aprovuar kërkesën me vendimin HPCC/D/78/2003 të datës 27 Qershor 2003 dhe kishte urdheruar që paraqitësit të kërkesës t'i kthehet posedimi mbi pronën e kërkuar.
 9. Më 30 prill 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPPK) me vendimin e vet grupor KPCC/D/R/237/2014, ka vendosur që D.S. është pronarë i 1/1 të pronës banesore të kërkuar të evidentuar në parcelën kadstrale 4406/4 dhe bartës i së drejtës së shfrytëzimit të

tokës së theksuar dhe se paraqitësi i kërkesës në kapacitetin e anëtarit të familjës duhet t'i kthehet posedimi mbi pronën e kërkuar. Në pikën 34 të Vendimit të KKPK-së për shkak të ndrrimit të strukturës Sekretariati Ekzekutiv në bashkëpunim me Komisionin apo Gjykatën mundet që të shtyjë zbatimin e urdhrin për dëbim për një afat të arsyeshëm kohor dhe të konsideroi mundesinë e zgjedhjes me mirëkuptim të kontestit.

10. Më 27 gusht 2014, vendimi i KKPK-së i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës (tani e me tutje: pala ankuese). Ai ka paraqitur ankesë pranë Gjykatës Supreme më 24 shtator 2014.

Pretendimet e palës ankuese:

11. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së (në tekstin e mëtejme “vendimi i ankimuar”) është i bazuar në një vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Ai deklaron se me këtë vendim nuk është përfshirë prona e kërkuar në ngastrën 4406/5 që përfshinë tokë ndërtimore prej 83 metrash katrorë.
12. Pala ankuese ka shpjeguar se me vendimin e ankimuar është vendosur vetëm për ngastrën 4406/4 dhe për këto arsye ai ka kërkuar që vendimi të priset ose të ndryshohet dhe të përfshihet tërë pasuria e pretenduar në kërkesën KPA50325.
13. Për ta mbështes ankesën e tij, pala ankuese ka paraqitur dokumentet e njëjta të paraqitura në procedurë para AKP-së/KKPK-së. Ai tutje kërkon nga Gjykata Supreme që ta caktojë një seancë dëgjimore.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës:

14. Ankesa është paraqitur brenda afati prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që ndërlidhen me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, (në tekstin e mëtejme Ligji i 03/L-079). Pala ankuese vendimine kishte pranuar më 27 Gusht 2014 kurse ankesën e kishte parashtruar me 24 Shtator 2014. Gjykata Supreme ka juridiksion ndaj ankesave kundër vendimit të KKPK-së.

Ankesa është e pranueshme.

Meritat e ankesës

15. Gjykata gjeti se Sekretariati Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare të Pronave pasi ka përfunduar procesin e verifikimit të kërkesës ka gjetur se në kërkesën KPA50325 përfshihën dy parcela të ndryshme dhe lehtësim të identifikimit të pronës dhe përpunimit të kërkesave ka vendosur që ta ndaje nga kërkesa origjinale KPA50325 dhe ta formoi edhe një kërkesë të re KPA91584 për ngastrën kadastrale 4406/5 ashtu siç ka vepruar edhe me kërkesat e tjera të cila kanë përfshirë më shumë ngastra fizikisht afër njëra tjetres.
16. Në shkresat e lëndës gjendet njoftimi mbi ndarjen e parcelave nga kërkesa KPA50325 në edhe një KPA91584 ashtu që kërkesa KPA5035 mbetet për ngastrën 4406/4 kurse kërkesa KPA91584 ka për objekt pronën në ngastrën 4406/05
17. Ky veprim i Sekretariatit bazohet në rregullat e brendshme të lehtësimit të përpunimit të kërkesave sipas propozimit të Sekretariatit të pranuar nga Komisioni me datën 15 prill 2009.
18. KKKPK-ja në vendimin e vet KPCC/D/R/237/2014 ka vendosur në favor të paraqitësit të kërkesës vetëm për kërkesën KPA50325 dhe nuk ka shqyrtuar meritat e kërkesës KPA91584 në lidhje me parcelat 4406/5.
19. Bazuar në të dhënat zyrtare të AKP-së, kërkesa KPA91584 ka qenë objekt shqyrtimi i KKKPK-së me vendimin e saj KPCC/D/R/270/2014 të datës 17 Dhjetor 2014. Bazuar në të njëjtat të dhëna Paraqitësi i kërkesës e ka pranuar vendimin e Komisionit me 5 Maj 2015.
20. Gjykata nuk shqyrtoi meritat e ankesës në lidhje me pronën e kërkuar 4406/5 në kërkesën KPA91584 për shkak se kjo nuk ishte objekt i vendosjes nga KKKPK-ja.
21. Gjykata nuk shqyrtoi meritat e ankesës lidhur me pronën e kërkuar në KPA91584 sepse nuk ishte objekt vendosje e Komisionit kurse nuk gjeti asnjë shkelje të dispozitave procedurale e as të ligjit material lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit që lidhet me kërkesën KPA50325. Pretendimet ankimore se vendimi duhej të përfshinte tërë pronën e kërkuar nuk mund të mbështetje për faktin se pjesa e mbetur e pronës së kërkuar ishte shqyrtuar me vendim të posaçëm të Komisionit.
22. Prandaj, ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i KKKPK-së duhet të vërtetohet në pajtim me nenin 13.3 (c) të Ligjit të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Këshillë juridike:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridik.

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit

Roland Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami , Gjyqtar

Urs Nufer , Referent i EULEX-it